



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28.04.2021

Nr: 217

URDHËR

PËR

**VIJIMIN E PROCESIT TË NUMËRIMIT TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR KANDIDATËT
E LISTAVE SHUMEMËRORE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE**

Në mbështetje të pikës 1, shkronja “b”, dhe pikës 2, të nenit 19, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 14 datë 10.04.2021, të Komisionit Rregullator, “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, rradhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të Zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend”, duke marrë shkas nga problematikat e hasura përgjatë procesit të numërimit të votave të kandidatëve të listave shumemërore të subjekteve zgjedhore

URDHËROJ:

1. Komisionet e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe Grupet e Numërimit të Votave të vijojnë pa ndërprerje dhe pa vonesa procesin e vlerësimit të votave për kandidatët e listës shumemërore të subjektit zgjedhor.
2. Anëtarët e grupeve të numërimit të votave (GNV-të) në rast se kanë vërejtje mund t'i pasqyrojnë ato pa asnjë kufizim në Tabelën të Rezultateve të Qendrës së Votimit dhe në procesverbal.
3. Ngarkohen KZAZ-të dhe Grupet e Numërimit për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 28.04.2021

Nr. 4662

Për vijimin e procesit të numërimit të fletëve të votimit për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore